



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2023:149221  
Datë: 19.04.2024  
Numri i dokumentit: 05594169

2023:149221

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Blerina KURTAJ, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësit D.I., nga fsh. ... Komuna Gjakovë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Ilir Rogova, avokat në Gjakovë, kundër të paditurës Universiteti "Fehmi Agani" në Gjakovë, me objekt kontesti pagesa mbi bazën e përqindjes së inflacionit, vlera e kontestit 999.00 Euro, jashtë seance me datë 19 prill 2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditëses D.I., nga fsh. .. Komuna Gjakovë, dhe DETYROHET e paditura Universiteti "Fehmi Agani" në Gjakovë, që paditësit së lartcekur, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit për periudhën kohore nga 21.06.2020 e deri me datë 21.11.2022, të ia paguajë shumën e përgjithshme prej 870.69-€ (tetëqind e shtatë e dhjetë euro e gjashtëdhjetë e nëntë cent) me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të filloi të llogaritet nga data 21.06.2023 (datë e parashtrimit të padisë) deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit me detyrim.

II. REFUZOHET e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadiës së paditëses mbi shumën e aprovuar sikurse në dispozitivin nën I të këtij aktgjykimi e deri në shumën e kërkuar dhe atë në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit, në shumën prej 128.31 -€.

III. DETYROHET e paditura Universiteti "Fehmi Agani" në Gjakovë, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësit të ia paguaj shumën prej 124.00.-€ (njëqind e njëzetë e katër euro) në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarrimit me detyrim.

## A r s y e t i m

Paditësi D.I., nga Komuna e Gjakovës në këtë gjykatë me datë 21.06.2023, përmes të autorizuarit të saj Ilir Rogova, avokat në Gjakovë ka ushtruar padi kundër të paditurës Universiteti “Fehmi Agani”, për pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, duke theksuar se paditësi është e punësuar si zyrtar për sigurim të cilësisë, në universitetin “Fehmi Agani”, Komuna Gjakovë. Në bazë të nenit 35 par.10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e paditura ka për obligim që për çdo vit të përcjellë shkallën e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e inflacionit të futet në pagë të paditëses. Meqë e paditura nuk e ka përmbushur këtë detyrim, paditësja ka paraqitur padi përmes të cilës ka kërkuar që të i kompensohet diferenca e inflacionit në pagë nga data 19.04.2017 e deri me datë 22.11.2022, të ia paguajë shumën e përgjithshme prej 999.00 -€ Euro, e ka kërkuar kamatën ligjore si dhe shpenzimet procedurale.

E paditura Universiteti Fehmi Agani, përmes të autorizuarit të saj, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 04.04.2024, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar, duke mos e kontestuar faktin që paditësja është në marrëdhënie pune te paditësja, mirëpo ky kompensim paditëses nuk i takon as me kontratën e punës, e gjithashtu as me Ligjin e Punës. Tutje ndër të tjera ka shtuar se paditëses nuk i takon e drejta e kompensimit të inflacionit KKA është në kundërshtim me ligjin e punës, dhe kjo kontratë nuk është e bazuar në ligj, si dhe është në kundërshtim me legjislacionin tjetër në fuqi në Republikën e Kosovës, si me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësit nr.03/L-048 me plotësim ndryshimet e tij( më tutje si në përgjigje ne padi). Po ashtu, ka cekur se padia e paditësit duhet refuzuar për shkak të parashkrimit të kërkesës së paditësit për kompensim në kuptim të nenit 353 par 1. Të LMD-së e po ashtu edhe me dispozitën e nenit 87 të Ligjit t Punës. Ka propozuar që të refuzohet si e pa bazuar kërkesë padia e paditësit, si dhe t’i kompozohen shpenzimet e procedurës.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e themeltë dhe si e tillë u aprovua.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi, dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga Akt emërimi për paditësin e lëshuar nga Universiteti Fehmi Agani, nga këtu e paditura, vërtetohet fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura në Universitetin “Fehmi Agani” në Gjakovë, si zyrtar për sigurim të cilësisë. Bazuar në Listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditëses është shuma prej 500.00 euro në vitin 2020, kurse 768.75 për vitet në vijim 2021 dhe 2022. Po ashtu, gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit i publikuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2020 ka qenë 0.2%, për vitin 2021 ka qenë 3.4%, ndërsa për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Provave të lartcekura gjykata iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021 e cila ka qenë në fuqi deri me datë 21.11.2022, ku në mënyrë identike në nenin 35 par.10 kanë përcaktuar se *“Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”*, ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditësit i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që një dispozitë e tillë është e karakterit imperativ dhe si e tillë do të duhej që shkalla e inflacionit të llogaritet në pagë, marrë parasysh që nga lista e pagave që gjendet në shkresat e lëndës, nuk rezulton që një pagesë e tillë është kryer nga e paditura.

Sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë, gjykata vendosi duke pasur parasysh të dhënat e nxjerra nga Enti i Statistikave të Kosovës sa i përket shkallës mesatare vjetore të inflacionit, përkatësisht ngritjes zingjyrore të inflacionit ndër vite dhe atë duke filluar llogaritjen nga viti muaji i gjashtë i vitit 2020 deri në vitin 2022 sipas përlllogaritjes si në vijim:

- Për periudhën Qershor - Dhjetor 2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, andaj duke e llogaritur pagën e paditësit sipas shtimit dinarik e cila në vitin 2020 do të duhej të ishte 500.00 euro, atëherë i bie që shuma e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për periudhën 7 mujore në total të jetë 7.00 euro, apo 1.00 euro për muaj ( $500.00 * 0.2\% * 7 = 7.00$ ).
- Për periudhën Janar - Dhjetor 2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, andaj duke e llogaritur pagën e paditësit sipas shtimit dinarik e cila në vitin 2021 do të duhej të ishte 500.00 euro, atëherë i bie që shuma e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për periudhën 12 mujore në total të jetë 204.00 euro, apo 17.00 euro për muaj ( $507.00 * 3.4\% * 12 = 204.00$ ).
- Për periudhën Janar - Nëntor 2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, andaj duke e llogaritur pagën e paditësit sipas shtimit dinarik e cila në vitin 2022 do të duhej të ishte 524.24 euro, atëherë i bie që shuma e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për periudhën 11 mujore në total të jetë 659.69 euro, apo 59.97 euro për muaj ( $517. * 11.6\% * 11 = 659.69$ ).

Duke qenë se mes palëve nuk është kontestuese gjendja faktike përkatësisht se paditësi është i punësuar tek e paditura në pozitën zyrtar për sigurim të cilësisë, nga data 20.11.2015 pa afat të caktuar, dhe në pagën e paditësit nuk është përfshirë edhe shkalla e caktuar e inflacionit, të cilat fakte nuk i ka kontestuar as e paditura në përgjigjen në padi, edhe përkundër faktit se e njëjta e ka kundërshtuar kërkesëpadinë, gjykata erdhi në përfundim se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance konform nenit 398 të LPK-së ku parashihet që *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, për çka vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerësoi pretendimin e të paditurës në lidhje me mungesën e bazës ligjore të kërkesëpadisë me arsyetimin se Ligji i Punës nuk e ka paraparë pagesën e kompensimit mbi bazën e inflacionit, mirëpo këtë pretendim e refuzoi për shkak se baza e kërkesëpadisë rrjedh nga Kontrata Kolektive e Arsimit, e cila bazohet në Ligjin nr.03/L-212 të Punës. Sa i përket

pretendimit të dhënë në përgjigje në padi se në rastin në fjalë kemi parashkrim të kërkesës, gjykata e aprovoj pjesërisht si të bazuar një pretendim të tillë, për arsye se konform nenit 87 të Ligjit nr.03/L-212 të Punës, i njëjti ka përcaktuar se *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, e që në rastin konkret paditësi ka kërkuar që të i kompensohet pagesa e inflacionit në pagë për periudhën kohore prej datës 19.04.2017 e deri me datë 22.11.2022 ndërsa padinë e ka paraqitur me datë 21.06.2023, për çka kërkesa mbi shumën e aprovuar u refuzua si e pa bazuar si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Kurse, pretendimet e tjera të të paditurës gjykata i vlerësoj si pa bazë për vendosje ndryshe.

Lartësia e kamatës së përcaktuar prej 8%, i referohet nenit 382 të LMD-së dhe kamata është llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë.

E për më tepër, gjykata përlllogaritjen e përfshirjes së inflacionit në pagën bazë e ka filluar nga muaji i 6-të i vitit 2020 duke shtuar normën e inflacionit vit për vit deri në vitin 2022 (*shtimi dinarik*), andaj gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke pasur parasysh se edhe në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës të përcaktuara në nenin 399 të LPK-së, ku në paragrafin 1 të këtij neni është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*, ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se *“Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërthënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadia qartazi janë në kundërthënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”*.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale si në pikën III të dispozitivit, gjykata e mori sipas nenit 449 dhe 452 të LPK-së, me ç ‘rast paditësit iu pranua shumë e shpenzimeve në vlerë prej 124.00.€. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara i referohet shpenzimeve për pagesën e taksës gjyqësore në vlerë prej 20.00.-€ (e paraparë sipas Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore), për përpilimin e padisë shumë prej 104.00.-€, e paraparë sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës Nr. Tarifor 6 dhe 17).

Nga të lartcekurat, gjykata bazuar në nenin 143 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË**

Departamenti i Përgjithshëm

2023:149221, datë 19 prill 2024

Gj y q t a r j a,  
Blerina KURTAJ

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.